

VENDIM

Nr. 686, datë 29.7.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

ZHVILLIMI I PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

1. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1.1 Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përfshin:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

¹ ¹Ky vendim synon të bëjë përafrimin e plotë të Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011, “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private” (celex-32011L0092, OJ. L 26, 28.1.2012), të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014 (celex-32014L0052, OJ. L 124, 25.4.2014).

- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

1.2 Raportin paraprak të VNM-së, ku përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç)një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Raporti i paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar.

1.3 Aktin e regjistrimit të personit fizik/juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

1.4 Një kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1, më sipër, dorëzohet edhe me CD/DVD, në të paktën 10 kopje.

3. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit, bën këto veprime:

a) Kërkon me shkrim, plotësimin e dokumentacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës, nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 1, më sipër. Afati për plotësimin e dokumentacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike;

b) Përcjell aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike, nëse aplikimi duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues:

a) i kërkon zhvilluesit, me shkrim, plotësimin e informacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës, kur konstaton se nuk mund të marrë vendimin për arsye se informacioni i dorëzuar nga zhvilluesi nuk është i plotë apo i qartë, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë. Afati për plotësimin e informacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike;

b) u dërgon për mendim/konsultim kopje të aplikimit, në CD/DVD, institucioneve të mëposhtme, të cilët shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:

i) Ministrive të linjës, në varësi të projektit;

ii) Institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin / autorizimin / licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

iii) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. ARM-ja, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentacionit nga AKM-ja, u dërgon një kopje të tij njësisë/ve së qeverisjes vendore (NJQV) që administron territorin ku propozohet projekti asaj/atyre që preken nga projekti i propozuar, të cilat shprehen, brenda 6 (gjashtë) ditëve kalendarike pune nga marrja e shkresës së ARM-së.

6. AKM-ja informon publikun, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje.
7. AKM-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalenda- rike nga data e marrjes së aplikimit, merr vendimin për VNM-në paraprake ose vendos që projekti t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, sipas formatit të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi, ia përcjell vendimin Ministrisë dhe e publikon në faqen e saj elektronike.
8. AKM-ja mbështetet në kriteret ndihmëse të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 11, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, për marrjen e vendimit.
9. Në rast se institucionet e konsultuara më lart kërkojnë informacion shtesë, AKM-ja, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga marrja e mendimeve, i kërkon zhvilluesit, me shkrim, plotësimin e informacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës dhe duke vënë në dijeni edhe Ministrinë. Afati për plotësimin e informacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.
10. Vendimi regjistrohet në Regjistrin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të AKM-së, dhe publikohet në faqen elektronike të saj.
11. Ministria ia dërgon vendimin zhvilluesit. Vendimi publikohet në faqen elektronike të Ministrisë.
12. Afati maksimal për dërgimin e vendimit te zhvilluesi është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga aplikimi pranë Ministrisë. Afati për plotësimin e dokumentacionit, sipas pikave 3, shkronja "b", 4, shkronja "a" dhe 9, të këtij kreu, nuk llogaritet në afatin maksimal. Në rast se zhvilluesi nuk plotëson dokumentacionin/informacionin brenda afateve të përcaktuara në pikat më sipër, nënkupton që zhvilluesi ka hequr dorë nga aplikimi për VNM-në paraprake.

KREU II

ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-së

1. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i procedurës së thelluar të VNM-së, njofton, me shkrim, ministrinë që në fazat fillestare të zhvillimit të projektit (projekt-idesë), duke e shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:
 - 1.1 Raportin teknik të projektit të propozuar, i cili përfshin:
 - a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
 - b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
 - c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;
- f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;
- i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.
- k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

1.2 Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit, i cili përmban:

- a) një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;
- c) një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër;
- ç) një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2. Dokumentacioni i kërkuar në pikën 1, më sipër, dorëzohet edhe me CD/DVD, në të paktën 10 kopje.

3. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit, bën këto veprime:

a) Kërkon, me shkrim, plotësimin e dokumentacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës, nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi nuk është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi. Afati për plotësimin e dokumentacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike;

b) Përcjell aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike për çështjet që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqëruar:

a) i kërkon zhvilluesit, me shkrim, plotësimin e informacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës, kur konstaton se nuk mund të marrë vendimin për arsye se informacioni i dorëzuar nga zhvilluesi nuk është i plotë apo i qartë, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë. Afati për plotësimin e informacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike;

b) u dërgon për mendim/konsultim, për çështje që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, kopje të aplikimit në CD/DVD, institucioneve të mëposhtme, të cilat shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:

i) Ministrive të linjës, në varësi të projektit;

ii) Institucioneve të tjera, që në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin /autorizimin / licencimin e tij, apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile;

iii) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentacionit nga AKM-ja, u dërgon një kopje të tij njësisë/ve së qeverisjes vendore (NJQV) që administron territorin ku propozohet projekti dhe asaj/atyre që preken nga projekti i propozuar, të cilët shprehen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pune nga marrja e shkresës së ARM-së.

6. AKM-ja, pas marrjes së mendimeve nga institucionet e pikës 4, më sipër, njofton, me shkrim, zhvilluesin për çështje që duhet të trajtojë në raportin e thelluar të VNM-së, duke vënë në dijeni dhe ministrinë, si:

a) kërkesat e saj dhe të institucioneve, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;

b) analizimin e alternativave të mundshme për zbatimin e projektit;

c) udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashi-kimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

ç) strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së, në përputhje me shtojcën II, të këtij vendimi;

d) udhëzime në rastin kur projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së.

7. Afati maksimal nga marrja e njoftimit, sipas pikës 1, të këtij kreu, deri në njoftimin me shkrim të zhvilluesit, sipas pikës 6, të këtij kreu, është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike. Afati kohor për plotësimin e informacionit, sipas pikave 3, shkronja “a” dhe 4, shkronja “a”, më sipër, nuk përlogaritet në afatin maksimal. Në rast se zhvilluesi nuk plotëson dokumentacionin/informacionin brenda afateve të përcaktuara në pikat më sipër, nënkupton që zhvilluesi ka hequr dorë nga procedura për VNM-në e thelluar.

8. Zhvilluesi, pas marrjes së njoftimit nga AKM-ja sipas pikës 6, më sipër, harton projektraportin e thelluar të VNM-së dhe organizon dëgjuesën me publikun, sipas procedurave të legjislationit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje.

9. Në përfundim të dëgjuesës zhvilluesi harton Raportin e Thelluar të VNM-së, sipas kriterëve të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Për t'u pajisur me Deklaratën Mjedisore zhvilluesi aplikon pranë Ministrisë dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm, dhe në format CD/DVD, në të paktën 10 kopje:

a) Raportin e thelluar të VNM-së;

b) Përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;

c) Raportin teknik përfundimtar, të hartuar sipas kërkesave të pikës 1.1, të këtij kreu;

ç) Përmbledhje të konsultimeve me publikun dhe palët e tjera të interesuara, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

d) Një kopje të faturës të pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislationin përkatës.

dh) Aktin e regjistrimit të subjektit, sipas legjislationit në fuqi.

11. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit, bën këto veprime:

a) Nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi nuk është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, atëherë kërkon, me shkrim, plotësimin e dokumentacionit që mungon, duke dhënë edhe arsyetimin përkatës. Afati për plotësimin e dokumentacionit nga zhvilluesi nuk mund të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike;

b) Përcjell aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike në lidhje me sugjerimin që do t'i jepet autoritetit planifikues, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 10440/2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, si dhe për kushtet që do të përcaktohen në deklaratën mjedisore;

12. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit, publikon në faqen zyrtare përmbledhjen joteknike të Raportit të Thelluar të VNM-së, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje.

13. AKM-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit, shqyrton dokumentacionin dhe harton Deklaratën Mjedisore, sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendim, dhe ia dërgon ministrit.

14. Ministri, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, lëshon Deklaratën Mjedisore ose ia kthen deklaratën AKM-së për rivlerësim, me argumentet përkatëse. AKM-ja dërgon te Ministri deklaratën e rivlerësuar, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike.

15. Ministra ia dërgon Deklaratën Mjedisore zhvilluesit dhe një kopje të saj AKM-së. Deklarata Mjedisore publikohet në faqet elektronike të Ministrisë dhe AKM-së.

16. Format i Deklaratës Mjedisore është sipas shtojcës V, bashkëlidhur këtij vendimi.

KREU III

TRANSFERIMI I VENDIMIT APO I DEKLARATËS MJEDISORE

1. Kur zhvilluesi ndryshon pasi ka përfunduar procedura paraprake e VNM-së, zhvilluesi i riparaqet pranë AKM-së kërkesën për transferimin e vendimit, duke paraqitur kërkesën, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin ekzistues;
- b) Dokumentin për kalimin e veprimtarisë nga zhvilluesi ekzistues te zhvilluesi i ri;
- c) Aktin e regjistrimit të subjektit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Transferimi i vendimit për procedure paraprake të VNM-së bëhet me shkresë të titullarit të AKM-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Kur zhvilluesi ndryshon, pasi ka përfunduar procedura e thelluar e VNM-së, zhvilluesi I riparaqet pranë Ministrisë kërkesën për transferimin Deklaratës Mjedisore, duke paraqitur kërkesë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Deklaratën Mjedisore ekzistuese;
- b) Dokumentin për kalimin e veprimtarisë nga zhvilluesi ekzistues te zhvilluesi i ri;
- c) Aktin e regjistrimit të subjektit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Transferimi i Deklaratës Mjedisore bëhet me urdhër të ministrit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

KREU IV

MONITORIMI I NDIKIMEVE, KONFIDENCIALITETI, ANKIMIMI DHE KOMUNIKIMI

1. Gjatë zbatimit të projektit, zhvilluesi ka përgjegjësinë të kryejë monitorimin e ndikimeve të tij në mjedis, në përputhje me përcaktimet në deklaratën mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.
2. Në rast se zhvilluesi gjykon se të dhëna të caktuara në dokumentacionin e kërkuar nga procedura e VNM-së janë konfidenciale, atëherë ai ia komunikon atë AKM-së që në momentin e paraqitjes së dokumentacionit ku përmbahen të dhënat konfidenciale.
3. Në rast se AKM-ja njoftohet, paraprakisht, nga zhvilluesi për ruajtjen e të dhënave konfidenciale, atëherë ajo zbaton kërkesat e legjislacionit përkatës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, si dhe të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.
4. Çdo palë ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së VNM-së, në përputhje me kërkesat e nenit 25, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 13, datë 4.1.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, dhe urdhri nr. 1859, datë 1.8.2014, i Ministrit, “Për miratimin e formatit të vendimit për VNM-në paraprake, vendimit për VNM-në e thelluar dhe të deklaratës mjedisore”, shfuqizohen.
 2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike nga data 1 shtator 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA I

KRITERET NDIHMËSE PËR MARRJEN E VENDIMIT GJATË PROCEDURËS PARAPRAKE TË VNM-së

1. Karakteristikat e projektit:

- madhësia e projektit;
- efektet kumulative me projekte të tjera;
- përdorimi i burimeve natyrore;
- prodhimi i mbetjeve,
- volumi i shkarkimit të ndotjes dhe zhurmës në mjedis;
- mundësia e aksidenteve me pasoja në mjedis, duke pasur parasysh, në veçanti, substancat apo teknologjitë e përdorura.

2. Karakteristikat e mjedisit në zonën e projektit:

- a) përdorimi ekzistues i tokës së kërkuar nga projekti;
- b) gjendja e mjedisit në zonën ku propozohet projekti, duke i kushtuar vëmendje të veçantë:
 - ligatinave;
 - zonave bregdetare;
 - zonave pyjore;
 - zonave të mbrojtura natyrore, me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare dhe distanca e tyre nga zona ku propozohet projekti;
 - biodiversitetit të zonës dhe statusit të ruajtjes/mbrojtjes;
 - zonat ku janë tejkaluar standardet e cilësisë së mjedisit (të përcaktuara në akte të tjera);
 - zonat me densitet të lartë të popullsisë;
 - ekzistencës së infrastrukturës mjedisore dhe aksesit të projektit në vendet e depozitimit të mbetjeve dhe në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura;
 - objekte me rëndësi historike, kulturore ose arkeologjike.

3. Karakteristikat e ndikimit të mundshëm në mjedis

Ndikimet e mundshme në mjedis të projektit të propozuar duhet të shqyrtohen në kombinim me kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2, më lart, dhe duke marrë parasysh, në mënyrë të veçantë:

- llojin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis;
- shtrirjen hapësinore të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe kohëzgjatjen e mundshme të tyre (zonën gjeografike dhe madhësinë e popullsisë së prekur);
- shkallën dhe kompleksitetin e ndikimit;
- mundësinë e shfaqjes së ndikimeve;

- natyrën ndërkufitare të projektit dhe ndikimin në mjedisin ndërkufitar;
- mendimet dhe kërkesat e dhëna nga institucionet, sipas kreut I, duke i përqendruar në:
- ekzistencën dhe planet e përdorimit të tokës dhe zhvillimin në zonën e projektit;
- përputhjen e projektit me planet vendore, rajonale dhe kombëtare të zhvillimit;
- kërkesa të veçanta për mbrojtjen e shëndetit publik nga ndikimet në mjedis të projektit.

SHTOJCA II

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONI QË PËRMBAN RAPORTI I THELLUAR I VNM-së

Hyrje

Shpjegimi i akronimeve

1. Informacion për qëllimin e VNM-së dhe metodikën e zbatuar

- a) Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së;
- b) Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin;
- c) Përshkrim të metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së:
 - Autorët e hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
 - Metodikat e zbatuara dhe mënyra e sigurimit të informacionit për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së (nëse është e detajuar mund të vihet edhe si shtojcë e raportit);
 - Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
 - Një përshkrim të vështirësive (mangësive teknike ose të njohurive) që zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar.

2. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë:

- a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen, në hartë topografike, sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të shoqëruar me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve;
- c) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- ç) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- d) infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

dh) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

e) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;

ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

f) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth /pranë zonës së projektit;

g) informacion lidhur me alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

gj) përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.; informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

3. Një përshkrim i analizimit të alternativave të mundshme për zbatimin e projektit ose komponentëve të veçanta të tij (si: aksesit rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit etj.), si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternativë, si dhe, në rast se ka, mendimet dhe sugjerimet e institucioneve përgjegjëse që mbulojnë fushën e zbatimit të projektit.

4. Një përshkrim të gjendjes dhe vlerave ekzistuese të mjedisit, që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar, duke përfshirë:

4.1 Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit:

- Përshkrim të faktorëve klimatikë;
- Përshkrim gjeomorfologjik dhe të sizmiticitetit të zonës së projektit;
- Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit;
- Përshkrim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

4.2 Përshkrimin e biodiversitetit në zonën e projektit:

- Përshkrim të habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese;
- Përshkrim të vegjetacionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;
- Përshkrimin e faunës në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;
- Përshkrimin e zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

4.3 Përshkrimin e cilësisë së mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese:

- Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti;
- Probleme të tjera (nëse evidentohen), të tilla si: erozioni i tokës, zjarret, ndotje historike etj.;
- Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si: ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj.).

4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti:

- Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti;
- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës;
- Përdorimi i tokës në zonën e projektit;
- Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit;
- Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane.

5. Një përshkrim të ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen:

5.1 Ndikimet negative në mjedis:

- Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;
- Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit;
- Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve;
- Ndikimet negative shtesë (kumulative) në cilësinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore, si mineralet, pyjet, burimet ujore;
- Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si: zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj.);
- Në varësi të natyrës së projektit, një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis.

5.2 Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis:

- Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis;
- Shtirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuara (shkalla);
- Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jodirekte);
- Mundësia e zbutjes së ndikimeve dhe argumentimet përkatëse nëse për ndikime të caktuara nuk mund të zbatohen/ndërmerren masa zbutëse;
- Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.);

6. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit (nëse ka të tilla).
7. Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës së projektit.
8. Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ, të identifikuara në paragrafin 5, më sipër.
9. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.
10. Planin e menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit:
 - Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar për mbrojtjen e mjedisit, në secilën fazë të projektit;
 - Kostot përkatëse të zbatimit të masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit;
 - Plani i komunikimit dhe informimit të publikut për ndikimet në mjedis, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.
11. Shtojcat e raportit të thelluar të VNM-së:
 - Përmbledhje, në gjuhë joteknike, të raportit të thelluar të VNM-së;
 - Kërkesat e veçanta të AKM-së dhe institucioneve të konsultuara, sipas seksioneve “C” dhe “D”, të këtij vendimi;
 - Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të raportit të thelluar të VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyetimet se si janë adresuar ose jo në raportin e thelluar të VNM-së, përfshirë edhe kërkesat e mendimet e dhëna në dëgjuesën publike;
 - Listat e llojeve floristike dhe faunistike në zonën e projektit dhe statusi i ruajtjes/mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Referencat e burimeve të informacionit të përdorur në raportin e thelluar të VNM-së;
 - Certifikatën e specialistit/ëve që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.

SHTOJCA III

KRITERET NDIHMËSE PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË THELLUAR TË VNM-së DHE HARTIMIN E DEKLARATËS MJEDISORE

Gjatë shqyrtimit të raportit të thelluar të VNM-së dhe hartimit të deklaratës mjedisore, AKM-ja merr parasysh:

- a) mënyrën sesi është zbatuar procedura e VNM-së;
- b) mënyrën se si është zbatuar procedura e informimit, konsultimit dhe dëgjuesës publike;
- c) mënyrën sesi janë marrë në konsideratë, në raportin e thelluar të VNM-së, mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga palët e përfshira gjatë procedurës së VNM-së, sidomos ato të konsultimit e dëgjuesës publike;

ç) paraqitjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së, në përputhje me strukturën e shtojcës II;

d) ndikimet e mundshme negative në zonat e mbrojtura;

dh) llojet e ndikimeve negative të rëndësishme në mjedis, sasia, kohëzgjatja dhe shtrirja hapësinore e secilit prej tyre;

e) mundësia e zbatimit dhe efektshmëria e pritshme e masave zbutëse të propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të projektit;

ë) saktësia e të dhënave dhe informacionit të paraqitur në raportin e thelluar të VNM-së dhe verifikueshmëria e burimeve të të dhënave të përdorura;

f) përputhjen e projektit të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe normat e standardet mjedisore në fuqi;

g) përputhjen e projektit me planet ekzistuese të përdorimit të tokës dhe zhvillimit ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;

gj) konsiderimin e alternativave dhe analizës përkatëse për zbatimin e projektit të propozuar;

h) në rast të VNM-së ndërkufitare, mënyrën sesi është zbatuar procedura përkatëse.

SHTOJCA IV

VENDIM PËR VNM-në PARAPRAKE

Në mbështetje të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar,

dhe vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të

përgjegjëse e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, AKM-ja, pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar për Zhvilluesin me të dhënat, si më poshtë:

Person juridik/fizik (emri, nr. NIPTI, adresa)

Për të zhvilluar projektin (Titulli i projektit të propozuar, refero projektin në përputhje

me aktivitet e listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit të VNM-së) me vendndodhje , sipërfaqe , koordinata

Bazuar në nenin 11, të ligjit për VNM-në më poshtë po listojmë:

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

.....

2. Mendimin e institucioneve të konsultuara:

.....

3. Masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis:

a)

b)

c)

DREJTOR I AKM-së (emri, mbiemri, firma, vula)

VENDIM PËR VNM-në, TË THELLUAR

Në mbështetje të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar,

dhe vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të

përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, AKM-ja, pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar për Zhvilluesin me të dhënat, si më poshtë:

Person juridik/fizik (emri, nr. NIPTI, adresa,)

Për të zhvilluar projektin (Titulli i projektit të propozuar, refero projektin në përputhje

me aktivitet e listuara në shtojcat I dhe II të ligjit të VNM-së) me vendndodhje , sipërfaqe , koordinata

Bazuar në nenin 11, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar më poshtë po listojmë:

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

.....

.....

2. Mendimin e institucioneve të konsultuara:

.....

.....

DREJTOR I AKM-së (emri, mbiemri, firma, vula)

SHTOJCA V

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar,

vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi

e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, dhe me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për Zhvilluesin me të dhënat, si më poshtë

Person juridik/fizik (emri, nr. NIPTI, adresa)

Për të zhvilluar projektin (Titulli i projektit të propozuar, refero projektin në përputhje

me aktivitet e listuara në shtojcat I dhe II të ligjit të VNM-së) me vendndodhje , sipërfaqe , koordinata

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues: (Të zgjidhet një nga alternativat e mëposhtme:)

1. Miratimin e lejes së zhvillimit të atij projekti, pa asnjë vërejtje nga pikëpamja mjedisore;
2. Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;
3. Refuzimin e kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e ministrisë dhe, sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:
a).....
b)..... c).....
2. Konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;
3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun;
4. Arsytet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi;
5. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

a)..... b)..... c).....

Drejtör i AKM-së (emri, firma, vula) MINISTËR Emër, mbiemër (firma, vula)